



Komisionit Evropian

José Manuel Durão Barroso

Kryetar i Komisionit Evropian

Fjalim i kryetarit Barroso në simpoziumin ekonomik në Alpbah: "Tejkalimi i krizës me forcimin e Evropës"

Simpozium ekonomik në Alpbah/Alpbah

30 gusht 2012

Check Against Delivery
Seul le texte prononcé fait foi
Es gilt das gesprochene Wort

Kryetar i Forumit të Alpbahut Fischler,

Kancelar Faymann,

Zëvendës kancelar Spindelegger,

Ministra,

Ekselenca,

Të nderuar mysafirë,

Kam nderin të marr pjesë në forumin në Alpbah që njihet për kontributin e tij në debatin dedikuar Evropës. Otto Molden dhe themeluesit e tjerë të këtij forumi janë personalitete me të cilat unë mund të identifikohem përmes asaj se si ata e kuptojnë drejtësinë, luftën për demokraci e liri dhe përmes vizionit të tyre për një të ardhme më të mirë evropiane. Në të njëjtën kohë, mua nuk më mbetet gjë tjetër veçse t'i mahnitem guximit të tyre.

Burrat e mëdhenj që kanë themeluar këtë forum kanë lënë një trashëgimi të madhe që është rrënjësor thellë në vlerat evropiane: mundësi për tu takuar përtej kufijve, për të diskutuar, ndoshta edhe për të mos u pajtuar – por gjithnjë në suaza të kornizës Evropiane.

Jam ftuar këtu që të flas për krizën aktuale dhe strategjinë tonë për ta tejkaluar atë dhe për ta forcuar Unionin.

Ky vend bukur është i përshtatshëm në shumë aspekte. Viteve të fundit, Evropa i përngjan një grupi të alpinistëve: pasi kanë arritur në majë të malit, duke e parë horizontin e gjerë, ata janë kthyer prapa dhe shohin arritjen e tyre. Megjithatë, duke parë prapa ne nuk mund të shohim stuhinë para nesh.

Në ne nuk kemi vuajtur vetëm nga një stuhi por kemi vuajtur nga të paktën tre prej tyre: kriza nga borxhet që i ka prekur shtetet, bankat dhe bizneset; së dyti, kriza në sektorin financiar, përfshirë këtu edhe disa praktika të paqëndrueshme; dhe së treti humbja e konkurrencës nga disa shtete anëtare.

Të pambrojtur nga këto elemente ne duhet të bashkohemi, të veprojmë të bashkuar dhe të vendosur, ta gjejmë rrugën drejtë destinacionit tonë.

Zonja dhe zotërinj,

Ajo që e dallon këtë krizë nga krizat e mëparshme historike është ekzistenca e Bashkimit Evropian si një mburojë që mund të na mbrojë nga këto stuhi. Në fakt, ne jemi më të integruar se më parë. Të gjitha hapat e ndërmarra deri më tani për të luftuar krizën kanë rezultuar në më shumë integritime evropiane, e jo në më pak prej tyre.

Rruga jonë evropiane për të dalë nga kriza ka dy binarë, stabilitetin dhe rritjen. Gjatë vitit të fundit lavjerrësi politik dhe opinionin publik ka lëvizur nga fokusi mbi stabilitetin deri tek perceptimi i rritjes si synim kryesor. Megjithatë, është e palogjikshme të thuhet se kemi nevojë për njërin e nuk kemi nevojë për tjetrën, pasi të dyja duhet të bashkë-ekzistojnë nëse dëshirojmë të dalim nga kriza. Pa stabilitet nuk ka siguri në të ardhmen, nuk ka investime dhe nuk ka rritje. Por gjithashtu nëse nuk ka siguri për të ardhmen, është e vështirë të arrihet stabilitet në të tashmen.

Sfida e vërtetë me të cilën është ballafaquar Evropa ka qenë arritja e stabilitetit afatshkurtër dhe në të njëjtën

kohë zhvillimi i vizionit të Evropës për të ardhmen, një Evropë që do të sigurojë rritje të qëndrueshme dhe do ti mbrojë vlerat tona dhe modelin tonë social. Për më tepër, ne duhet ta bëjmë këtë në një botë që ndryshon në mënyrë të shpejtë.

Ne jemi rrugës për ta arritur këtë. Por rruga mbetet shkëmbore. Më lejoni të përqendrohemi në takimin e fundit të Këshillit Evropian të mbajtur në muajin qershor.

Ishte një takim shumë i rëndësishëm; takim në të cilin u sollën vendime që hapën perspektiva për një bashkësi më të bashkuar dhe më të integruar. Për fat të keq, komunikimi pas Samitit gjithashtu e tregoi ngasje që vendimet evropiane të bëhen nacionale, implementim kontradiktor.

Pse kemi nevojë për një Evropë më të bashkuar dhe më të integruar? Sepse kemi union monetar, por kriza ka treguar se ka logjikë kumulative në procesin integruar: unioni monetar nuk mund të funksionojë pa union financiar dhe bankar, si dhe pa union të mëtëjshëm fiskal dhe ekonomik. Këshilli Evropian miratoi një dokument të përgatitur nga Kryetari i Këshillit Evropian në bashkëpunim me mua, me Kryetarin e Bankës Qendrore Evropiane dhe me Kryetarin e grupit Euro, i cili e ka shqyrtuar mënyrën më të mirë se si të lëvizim përgjatë kësaj rruge.

Sigurisht që logjika e integritit nuk mund të jetë thjeshtë vetëm ekonomike. Për unionin bankar nevojitet një mbikqyrës i vetëm evropian; bashkimi i mëtëjshëm ekonomik gjithashtu kërkon një mbikqyrje të përbashkët evropiane mbi politikën ekonomike të shteteve anëtare. Andaj është e arsyeshme, por edhe e drejtë që të vazhdojë integrimi politik. Kjo është e nevojshme për të siguruar kontroll demokratik të proceseve dhe për bindjen e qytetarëve të Evropës se ky nuk është vetëm një projekt i elitave politike dhe ekonomike. Kjo është rruga për në mal. Disa thonë se ka rrugë tjetër; mund të zbrisim poshtë luginës, ose të paktën të gjejmë strehimore në gjysmë të rrugës. Unë nuk pajtohem me këtë. Ne nuk mundemi thjeshtë të qëndrojmë ku jemi ose të mudohejmë të tërhiqemi në status-quo.

Së pari, bota ka ndryshuar dhe ne, që të përballemi me konkurrencën, duhet të ndryshojmë gjithashtu. Së dyti, ashtu siç ka logjikë kumulative për integrimin, ka logjikë kumulative edhe për dezintegrim: avantazhet që ne i marrim për të parëndësishme – ndonjëherë edhe shumë të parëndësishme, rrezikojmë ti humbim: arritjet për qytetarët tanë siç është liria e lëvizjes, tregu i brendshëm, të drejtat sociale dhe solidariteti trans-evropian mund të zgjidhen.

Zonja dhe zotërinj,

Komisioni Evropian, më 12 shtator, do të propozojë propozime për krijimin e unionit evropian bankar. Ky është vizioni ynë për të gjeneruar besim për të ardhmen e Euros. Ky është aktivitet momental – edhe pse integrimi më i thellë ekonomik kërkon perspektivë më të gjatë.

Evropa ka nevojë për konsolidim fiskal, për reforma të thella strukturore dhe për investime të mençura nëse dëshirojmë t'i kthehemi rritjes afatgjate dhe të krijojmë vende të punës për të cilat kanë nevojë qytetarët tanë. Në Këshillin e fundit Evropian, ishte e qartë se është arritur shumë në drejtim të konsolidimit fiskal; deficitin mesatar është në rënie në tërë Bashkimin Evropian. Ky nuk është vetëm një koncept abstrakt – deficitin më të lartë nënkupton borxh më të madh që i largon investimet. Çdo euro e shpenzuar për të mbuluar borxhet është euro e humbur për investime të mençura.

Së dyti, të gjithë udhëheqësit janë pajtuar se reformat strukturore duhet të vazhdojnë. Komisioni Evropian tani është duke përgatitur rekomandime specifike vjetore për shtetet si pjesë të semestrit evropian për qeverisjen ekonomike. Rekomandimet përfshijnë një varg të politikave ekonomike duke filluar nga regjimet tatimore e deri në arsim. Synimi ynë nuk është të ligjërojmë por të japim udhëzime informative, të paanshme dhe të pavarura rreth procesit të reformave që duhet ta ndërmarrim të gjithë, për tu siguruar se ekonomia evropiane do të vazhdojë të jetë konkurrense në një botë e cila është duke na u afruar në mënyrë të shpejtë.

Diskutimet mes udhëheqësve të shteteve dhe qeverive dhe miratimi i rekomandimeve të sivjetshme kanë bërë

të qarta dy çështje. E para është se të gjithë e shohin rëndësinë e ushtrimit dhe e dyta është se shtetet anëtare janë të angazhuara në implementimin e rekomandimeve për reforma të Komisionit.

Zonja dhe zotërinj, nevoja për riorganizim nuk është e kufizuar në shtetet anëtare të BE-së. Bashkimi Evropian ka gjithashtu nevojë për punë dhe reforma. E para dhe më kryesorja është tregu i brendshëm, tregu më i madh në botë dhe burim i madh i konkurrencës, rritjes dhe prosperitetit evropian.

Tregu i brendshëm mund të ilustruhet këtu në Austri më mirë se gjithkund. Sa i përket tregtisë, Austria është shteti më i hapur për ekonominë tonë, gati dy herë më i hapur se mesatarja e tregut të brendshëm të Evropës. Austria dhe qytetarët e saj kanë përfituar jashtëzakonisht shumë nga kjo. Për shembull, pas zgjerimit të fundit, eksporti në shtete e reja anëtare është dyfishuar ndërsa të hyrat nacionale çdo vit në dekadën e ardhshme do të rriten për 0.2%. Për më tepër, Austria ka pranuar mbi 50 miliardë euro që nga integrimi në BE përmes investimeve të drejtpërdrejta nga jashtë, investime të cilat i kanë ndihmuar Austrisë të radhitet në vendin e 12 në listën e Forumit Botëror Ekonomik për inovacione.

Megjithatë, tregu i brendshëm nuk është plotë edhe 20 vite pas fillimit të tij. Prioritet duhet të jetë përfundimi dhe zgjerimi i cili do të gjenerojë përfitime të ardhshme. Vitin e kaluar, Komisioni e miratoi Dekretin për tregun e brendshëm i cili përmban 12 propozime që për momentin janë pranë Parlamentit Evropian dhe shteteve anëtare. Për disa javë, do ta propozojmë Dekretin 2 për tregun e brendshëm, për të vazhduar me këtë dinamikë. Gjithashtu, ne jemi duke inkuadruar masa plotësuese për të siguruar implementim të plotë të tregut të brendshëm për shërbime me vlerë prej 150 miliardë euro në vit. Kjo ka rëndësi të veçantë për Austrinë ku dy të tretat nga të hyrat nacionale burojnë nga sektori i shërbimeve, që është një bilanc pozitiv në tregtinë e saj të shërbimeve në Evropë.

Nëse tregu i brendshëm është një nxitës i rritjes dhe i vendeve të punës, atëherë tregu ynë i jashtëm, pjesa tjetër e botës, duhet të jetë nxitësi tjetër. Bashkimi Evropian është tregtari më i madh i botës dhe ne jemi duke punuar shumë për të hapur tregje të reja; përmes negociatave për tregti të lirë, përfshirë edhe propozimin e fundit të Komisionit që ka të bëjë me Japoninë, për të siguruar drejtësi në hapjen e tregut tonë përmes legjislacionit tonë për prokurime publike, dhe përmes gjetjes së mënyrave më të mira për thellimin e lidhjeve tregtare dhe investimeve me partnerët tanë kryesorë siç janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë mënyrë mund të përfitojnë edhe kompanitë austriake, me nivelin e tyre të lartë të konkurrencës ndërkombëtare.

Zonja dhe zotërinj,

Ne mund t'i konsolidojmë financat tona publike, mund të bëjmë reforma, të riorganizohemi dhe të krijojmë kornizë legjislative e cila do të prodhojë rritje dhe vende të punës dhe ne mund të hapim tregje. Por që të realizohen këto përfitime punëtorët dhe bizneset duhet të kenë aftësi dhe kapacitete që të kenë dobi nga këto mundësi të krijuara.

z. Kryetar,

Simpoziumi i sivjetshëm ekonomik i Alpbahut është përqendruar në mirëqenien e ardhshme sociale – një temë shumë aktuale. Me rëndësi të jashtëzakonshme është se përpjekjet aktuale për adaptim nga ana e disa shteteve anëtare, thelbi i sistemit të tyre për mirëqenie nuk është shpërbërë. Nëse ne duam – dhe duam me të vërtetë – ta ruajmë ekonominë e tregut social duhet të reformojmë disa aspekte të këtyre sistemeve. Por jo ta bëjmë këtë me çmim të kontestimit të parimeve dhe arritjeve të tyre.

Kriza aktuale ka qenë e rëndë veçanërisht për rininë tonë. Në Bashkimin Evropian më shumë se një nga pesë të rinj që kërkojnë punë nuk mund të gjejnë. Në disa shtete anëtare këto shifra janë një nga dy. Edhe kur ata kanë gjetur punë 42.5% nga të punësuarit e rinj janë me kontrata të përkohshme.

Këto numra demonstrojnë se kriza aktuale nuk është vetëm ekonomike. Ajo ka edhe dimension social që mund të nxisë shpërndarje më të thellë mes politikanëve dhe në mënyrë indirekte mes BE-së dhe qytetarëve të saj. Kjo çështje e gjerë duhet dhe do të jetë e adresuar. Një element është të demonstrojmë akoma më qartë se politikën tona mund të ndryshojnë jetën në të mirë.

Duhet të bëhet shumë më tepër sa iu përket investimeve për trajnim, harmonizimit më të mirë të shkathtësive

me nevojat e tregut të punës dhe largimit të barrës së taksave ndaj punës. Këto masa nuk paraqesin një dozë të shpejtë, por ata do të sigurojnë se, kur të kthehet rritja, do të jetë një rritje që rrjedh nga vende të reja të punës.

Aktiviteti kryesor lidhur me punësimet, përfshirë këtu edhe punësime të rinisë, do të mbesë natyrisht në nivel nacional. Për ta plotësuar këtë, BE-ja mund dhe do ta luajë rolin e saj. Në afat të shkurtër, Komisioni është duke i përdorur të gjitha investimet e tij dhe është duke punuar për së afërmi me qeveritë nacionale për luftën kundër papunësisë.

Në tetë shtete anëtare më të prekura ne kemi ndarë 7.3 miliardë euro nga fondet strukturore për përkrahjen e 170 000 ndërmarrjeve dhe kemi krijuar mbi 450 000 vende të punës. Por mbetet ende për tu bërë në Evropë si tërësi, dhe ne duhet të inspirohemi nga shtetet anëtare të avancuara mjaft dhe "që janë duke vepruar mirë", sidomos për rininë, siç është Austria. Unë kam përshtypje shumë pozitive nga vizita ime, së bashku me

Kancelarin Faymann, në një punëtori për persona të rinj të organizuar në muajin mars.

Kjo më sjell në elementin e tretë, që ka të bëjë me investimet e zgjedhura në mënyrë të mençur. Në kohë kur resurset për investim janë të kufizuara ne duhet të investojmë në mënyrë të mençur, në mënyrë strategjike dhe të sigurojmë se do të kemi përfitim maksimal nga çdo euro e shpenzuar.

Unë besoj se buxheti i Bashkimit Evropian ka rol të rëndësishëm. Buxheti jonë duhet të sigurojë investime, rritje për rajonet tona, për studentët, për bizneset, për fermerët dhe për të papunësuarit.

Sigurisht që në kohë të konsolidimit fiskal ky është një synim i lehtë. Por për një buxhet shumë të ulët – vetëm pak mbi 1% i PBB-së ka ndikim të jashtëzakonshëm dhe gjeneron përfitime shumë më të mëdha se sa kostoja e menjëhershme modeste.

Për shembull, Austria ka përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga 1.3 miliardë euro për rajonet më pak të zhvilluara për periudhën prej vitit 2007 e deri në vitin e ardhshëm. Për më tepër, përkrahja jonë ndaj procesit integruar të vendeve të Evropës Juglindore ka hapur tregje fitimprurëse për kompanitë Austriake. Nuk duhet të harrojmë se Austria ka qenë shumë e suksesshme në fitimin e financave evropiane për hulumtim me mbi 1200 projekte të suksesshme në kuadër të programit kornizë VI.

Me pak fjalë: nëse shtetet tona anëtare dëshirojnë të jenë serioze në investime që do të sjellin rritje dhe vende pune, atëherë duhet të përkrahjet një buxhet ambicioz, i qëlluar dhe real i BE-së me vlera të shtuara. Kjo është jetike për suksesin tonë të përbashkët evropian. Është e vështirë ta ngjimisim malin së bashku nëse secili e ka dorën e lidhur pas shpine.

Të nderuar mysafirë,

Unë e kam skicuar rrugën që duhet ta ndjekim, jo thjeshtë vetëm për ta tejkaluar krizën, por për të dalë si një Evropë më e fuqishme, Evropë më e bashkuar dhe më konkurrense; Evropë me rritje të qëndrueshme afatgjate; Evropë e cila iu mundëson njerëzve të rriten dhe e cila e vazhdon suksesin e saj ekonomik dhe social në mjedisin konkurrent global. Këtë ne ua kemi borxh gjeneratave të ardhshme të Evropianëve, të cilët janë fuqimisht të përfaqësuar në Alpbah.

Zonja dhe zotërinj,

Mund të prisni që një portugez të përmbyllë fjalimin me një metaforë detare. Por unë do të huazoj një citim alpinist- në fund të fundit, maja më e lartë e Portugalisë, Mali Piko në Azores, arrin një lartësi të mahnitshme prej 2351 metrash. E di këtë ngaqë jam ngjitur deri atje lartë. Ka qënë pjesë e kampanjës sime për tu bërë kryeministër.

Alpinisti i madh Tyrolean Peter Habeler për ngjitjen e tij te famshme të Everestit ka thënë pa frymë që kjo ngjitje nuk ishte një fitore ndaj malit- por një fitore ndaj vetes së tij! Dhe që kjo fitore nuk ishte arritur përmes përfundimit të udhëtimit, por përmes marrjes së hapave të parë. Kjo është e vërtetë, por mendoj që të gjithë

jemi dakord që ai tregoi forcë të madhe jo vetëm duke filluar udhëtimin, por edhe duke mbaruar atë me sukses.

Është pikërisht kjo ajo që na duhet për Evropën: të mbarojmë punën tonë, të kompletojmë unionin ekonomik dhe monetar, të jemi të vendosur dhe të qëndrueshëm, të jemi në rrjedha, të mos presim çudira por të përqëndrohemi në implementim dhe rezultate. Hap pas hapi. Por gjithmonë me mendjen tek një horizont i gjerë.

Rruga e Evropës është e pastër, dhe ashtu si Peter Habeler ne po vazhdojmë të vendosur. Por, e them përsëri, duhet shumë punë në nivel evropian dhe nacional nëse duam të ecim suksesshëm dhe të vazhdojmë së bashku udhëtimin tonë Evropian.